23 kërkesat sipas rregullit 107 deri në mes të nëntorit 2022 dhe
24 se vendime të tjera për autorizim mund të kërkojnë paraqitjen
25 e kërkesave të tjera.

1 Në parashtrimet me shkrim, Mbrojtja e Krasniqit ka
2 përsëritur kërkesën për një urdhër për vendosjen e një afati
3 për ZPS-në për të përfunduar nxjerrjen sipas rregullit 107, që
4 do të duhet që të zgjidhej përpara kalimit të çështjes Trupit
5 Gjykues.

6 Në fillim i kërkoj ZPS-së që të japë sqarime ne
7 parashtrimet e veta me gojë dhe pastaj Mbrojtjes, nëse
8 dëshirojnë.

9 Z. Halling, keni fjalën.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

11 Në lidhje me pikat e ndryshme të cilat sapo u përmendën.
12 Sa i takon materialeve që kanë marrë autorizim, kemi marrë më
13 datë 1 nëntor. Pra, jemi duke bërë këtë shqyrtim të materialit
14 që na është autorizuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më falni, sa i takon
16 shifrave, a përputhet me atë që ju keni bërë të ditur në
17 parashtrimet me shkrim?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon perspektivës së
21 vendosjes së një afati për autorizimet dhe materialet sipas
22 rregullës 107. Evolucionit, pra, siç janë zhvilluar gjërat,
23 tregon se nuk nevojitet asnjë afat. ZPS-ja i qëndron mendimit
24 të vet se po vijon negociatat, kontaktet dhe në varësi të
25 urdhrave të Trupit Gjykues mund të dorëzojë edhe kërkesat e

1 nevojshme.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

3 Ndonjë ekip i Mbrojtjes kërkon të bëjë parashtrime me
4 gojë?

5 Z. Kehoe.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk tha -- ishte
7 një numër materialesh që ende nuk kishin marrë autorizim, por
8 po shikoj edhe një herë që Prokuroria ka thënë 200, janë 200
9 dokumente që ende nuk kanë marrë autorizim, krahas atyre
10 tjerëve për të cilat kanë marrë autorizim të cilat nuk na i ka
11 nxjerrë ende.

12 Nga këto, pastaj ka dhe 50 dokumente të tjera të cilat do
13 të -- pra, mbasi ofruesi i këtij informacioni do të përfundojë
14 procesin e autorizimit, diçka më pak se 25 të këtyre
15 dokumenteve, përmbajnë material të rregullës 103.

16 Edhe këtu, ne jemi në errësirë sa i takon materialit 107,
17 siç ndodh zakonisht në këtë rast, nuk e dimë se për sa
18 informacion bëhet fjalë për shembull; dhe, e dyta, ne na
19 intereson shumë ky material i rregullës 103 edhe po të jetë më
20 pak sesa 25 dokumente. Nuk e di nëse 25 faqe? A 25 dokumente?
21 Nuk e di.

22 Prandaj dhe i lutem të nderuarit Gjykatës, që t'i japë
23 prioritet kësaj, sepse është material i rregullit 103, duhet
24 ta trajtojë menjëherë. Duam, sigurisht, ta shohim ta gjithë
25 informacionin, po sidomos informacioni sipas rregullit 103 ka

1 shumë rëndësi për ne.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Znj. O'Reilly.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Parashtrimi për afatin, siç
5 themi ne që nevojitet, ka lidhje me faktin që sugjerohet që do
6 ta kalojmë në gjykim. Po nëse kalojmë në gjykim dhe nuk
7 zgjidhet kjo? Nuk ka kuptim. Ne kemi nevojë për një afat për
8 këtë gjë. Pra, ka dhe materiale të tjera që lidhen me këtë
9 material, me thelbin e këtij materiali.

10 Është shumë e paqartë se ç'po ndodh këtu. Shumë pak na
11 është nxjerrë se kush janë këta ofrues, çfarë natyre ka ky
12 material. Sigurisht, askush prej nesh nuk mund ketë besim në
13 këtë parashtrim se më pak se 25 kanë informacion shfajësues.
14 Kemi nevojë të dimë më shumë dhe sa më shpejtë ta marrim vesh
15 këtë aq më mirë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Young.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Asgjë për të thënë, përveçse e
19 mbështesim afatin.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Procedura paraprake ka dy vjet që po
23 zhvillohet, fakti që është bërë progres kohët e fundit nuk
24 është arsye e fortë për të mos vendosur afat.

25 Ne kërkojmë që ta zgjidhim këtë gjatë procedurës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 52

1 paraprahe për të mos lënë çështje të pazgjidhura për Trupin
2 Gjykues më vonë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. E mbajta
4 shënim. Ju kuptova.

5 Z. Halling, doni të shtoni ndonjë gjë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Edhe njëherë avokati
7 i Thaçit na ka keqkuptuar.

8 Ne kemi marrë autorizim deri në parashtrimet me shkrim po
9 s'i kishim marrë ende materialet. Pra, ka më pak sesa rreth
10 200 materiale, tashti ka rënë në 50 këto materiale.

11 Sa i takon numrit të materialeve që janë sipas rregullit
12 103, ne shpresojmë që të jenë edhe më pak sesa 25 nga
13 ç'parashtronim në parashtrimet me shkrim të hënën, po kjo
14 varet shumë nga mënyra sesi janë redaktuar faqet.

15 Për shembull: Një material që ka marrë autorizim sipas
16 rregullit 103 [sipas përkthimit], po që është redaktuar nuk
17 merr autorizim sipas rregullit 103.

18 Prandaj dhe po bëjmë një vlerësim të faqeve që kemi marrë
19 tani. Pastaj, sa i takon çështjes që ZPS-ja vazhdon të mbajë
20 premtime, ne gjithmonë kemi pasur progres në marrjen e
21 autorizimeve për materiale të rregullit 107 dhe tani kemi
22 ardhur në një pikë ku kemi më pak sesa njëqind dhe ne do
23 kërkojmë që ky proces të vijojë në mënyrë që për të gjithë të
24 merren vendime të mira që të mos t'i drejtohem panelit pastaj
25 për zgjidhje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 53

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë shkurt, z. Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Me gjithë respekt, unë po lexoj se
3 çka parashtuar Prokurori:

4 "Deri në datën e këtij parashtimi janë 200 materiale që
5 ende nuk kanë marrë autorizim".

6 Nuk po e sajojmë ne, kështu e ka shkruar.

7 "Mbasi të merren këto materiale, pastaj numri që pritet
8 do të jetë më pak sesa 50".

9 Kështu ka shkruar Prokuroria. Ne thjesht duam të kuptojmë
10 se çdo na vijë më pas. Ç'materiale këto sipas rregullit 103 do
11 të marrim. Nuk duam të fajësojmë këtu asnjë, duam informacion
12 sot ose sa më shpejt, jo mbas dy muajsh apo mbas tre muajsh.
13 Kjo është çështja.

14 Nuk është thjesht për kërkesë të materialit 102(3). Duam
15 që këtë material të rregullit 103 ta marrim sa më shpejt, të
16 informohemi sa më shpejtë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Para se të kalojmë te
18 pushimi, kalojmë tek pika tjetër në rendin e ditës që duhet të
19 jetë e shkurtër, janë përkthimet.

20 Vërej se palët nuk kanë cekur probleme me përkthimet në
21 parashtimet me shkrim. Ftoj Zyrën Administrative që të na
22 japë një përditësim për përkthimet e mbetura pa përfunduar;
23 sidomos, çfarë ecurie ka pasur për përkthimin e aktakuzës së
24 të ndryshuar më tej dhe të tabelës së rregullit 109(c) dhe
25 listës plotësuese të saj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 54

1 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit.

2 Sa i takon tabelës së rregullit 109(c), besoj ju kujtohet
3 se në mars Mbrojtja e z. Krasniqi ka kërkuar përkthimin e
4 pjesëve të kësaj tabele në formë prioritare. Këto përkthime
5 janë dhënë me pjesë të ndryshme në prill, maj dhe e fundit në
6 korrik. S'ka pasur kërkesa të tjera në lidhje me këtë apo në
7 lidhje me tabelën e rishikuar.

8 Sa i takon aktakuzës së ndryshuar më tej, mund t'ju
9 raportoj se përkthimi në shqip është finalizuar dhe është në
10 proces të dorëzimit zyrtarisht të akuzuarve.

11 Përtej kësaj, nuk ka më kërkesa të tjera me prioritet për
12 përkthimin.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

14 Ka ndonjë që do të marrë fjalën për këtë temë? Nuk shoh
15 kërkesë për të marrë fjalën.

16 Në rregull. Shoh se është thuar një orë e gjysëm që kur
17 kemi filluar. Përpara se të kalojmë në pikën tjetër në rendin
18 e ditës, që janë hetimet e Mbrojtjes, do të bëjmë një pushim.

19 Do të rifillojmë pas 20 minutash, në orën 15.20 minuta.

20 Këtu ndërpresim seancën.

21 --- Pauza fillon në orën 14.59

22 --- Seanca rifillon në orën 15.22

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek

24 hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshme.

25 Së pari, vë re që autoritetet kosovare kanë caktuar një

1 pikë fokusi, siç është kërkuar nga Mbrojtja. Dua të falënderoj
2 zyrën Administrative për përpjekjet për këtë çështje.

3 Në parashtrimet e tyre me shkrim Mbrojtja ka treguar se
4 hetimet e tyre janë në vijim e sipër dhe ka të ngjarë që të
5 vazhdojnë edhe pas transmetimit të çështjes Trupit Gjykues.

6 Më 21 tetor 2022, katër ekipet e Mbrojtjeve parashtruan
7 dosjet e tyre para gjykimit sipas afatit që kam caktuar unë.

8 Vërej gjithashtu që Thaçi kërkon mundësi hetimore unike.
9 Dhe një vendim me shkrim do të nxirret përpara se t'i kalohet
10 çështja Trupit Gjykues për këtë çështje.

11 Gjithashtu mbaj parasysh dosjet e parashtruara të
12 Mbrojtjes së Thaçit, Veselit, Selimit sa i takon njoftimit për
13 alibi ose shkaqe për përjashtim të përgjegjësisë penale.

14 I falënderoj Mbrojtjet për parashtrimin e tyre lidhur me
15 këto pika.

16 Sa i takon pikave për të cilat palët bien dakord, ZPS-ja
17 tregon që aktualisht po rishikon propozimin e përbashkët të
18 Mbrojtjeve për faktet për të cilat bihet dakord midis palëve
19 dhe të trajtojë këto kërkesa.

20 Mbrojtja e Thaçit thotë që ka rënë dakord për 18 fakte me
21 ZPS-në dhe minimalisht të mund të japë njoftimin lidhur me 18
22 faktet për të cilat është rënë dakord më përpara me ZPS-në.

23 Mbrojtja e Selimit thotë që nuk ka rënë dakord për faktet
24 e tjera të mëtejshme propozuar nga ZPS-ja që prej Konferencës
25 së fundit për Ecurinë e Çështjes dhe diskutimet lidhur me këtë

1 çështje kanë përfunduar.

2 Gjithashtu, kjo Mbrojtje ka thënë që nuk ka diskutime
3 lidhur me pikat juridike ndërmjet palëve.

4 Në çdo rast, ZPS-ja dhe ekipet e Mbrojtjes së Thaçit,
5 Veselit dhe Selimit, treguan që një njoftim për faktet për të
6 cilat ata bien dakord, mund të parashtrihen deri më 18 nëntor
7 2022.

8 I ftoj palët të japin hollësi lidhur me diskutimet e tyre
9 *inter parte* për këtë çështje nëse dëshirojnë.

10 Po ashtu, në qoftë se katër ekipet e Mbrojtjeve
11 aktualisht nuk parashikojnë ndonjë vështirësi për parashtrimin
12 e njoftimit për kundërshtimin e pranueshmërisë së materialit
13 provues, në pajtim me rregullin 95 deri më 18 nëntor 2022.
14 Megjithatë, katër ekipet e Mbrojtjeve kanë thënë më tej që nuk
15 janë përqendruar në materiale të caktuara, por tek kategoritë
16 e provave të cilat mund të jenë objekt i kundërshtimeve
17 konkrete.

18 Mbrojtjet e Veselit, Selimit dhe Krasniqit kanë vënë re
19 më tej parashtrimet sa i takon pranueshmërisë dhe ato janë
20 paraprake në natyrën e tyre.

21 Më lejoni tani t'i jap fjalën palëve sa i takon hetimeve
22 të Mbrojtjes.

23 Së pari të fillojmë me z. Kehoe.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Dëshironi që t'i marr njëra pas tjetrës, apo të bëj një

1 parashtrim për të gjitha çështjet?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, të gjitha bashkë. Jo
3 siç i kemi diskutuar njëra pas tjetrës në konferencën e
4 mëparshme. Sepse për disa prej atyre ka kaluar koha, nuk është
5 më me vend që të diskutohen.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ne vazhdojmë që të marrim shtesa
7 sa i takon listës së dëshmitarëve të ZPS-së. Kemi marrë katër
8 dëshmitarë të tjerë, kemi marrë gjithashtu edhe 147 prova
9 materiale shtesë. Ndërkohë disa prej dëshmitarëve flasin për
10 çështje të cilat shkojnë përtej fushës së veprimit të
11 aktakuzës. Gjë e cila në vetvete na e vështirëson shumë më
12 tepër çështjen neve, ekipeve të Mbrojtjes.

13 Ne, i nderuari Gjykatës, kemi 66 paragrafë ose një numër
14 të madh paragrafësh në aktakuzë, të cilët janë redaktuar. Kemi
15 deklaratë të ZPS-së më 28 tetor që thotë që, për 54 paragrafë
16 do të hiqen redaktimet deri 30 ditë përpara gjykimit. Ndërkohë
17 që për 12 të tjera, 30 ditë përpara gjykimit. I nderuar
18 Gjykatës, ne kemi nevojë për ndihmën tuaj, sepse nuk e dimë se
19 përse duhet kaq shumë kohë për të hequr redaktimet nga këto
20 paragrafë. Një çështje që unë dhe ju e dimë, i nderuar
21 Gjykatës, ka të bëjë me alibinë dhe aftësinë për ta ngritur
22 këtë çështje.

23 E keni parë besoj që edhe në kuadrin e diskutimeve për
24 çështjen paraprake, edhe në procese të tjera të ecurisë së
25 çështjes, unë e kam ngritur këtë gjë që t'i drejtohem

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 58

1 dëshmitarëve të ndryshëm për të thënë se ku ka qenë z. Thaçi
2 në momente të caktuara të kohës. Siç e kam thënë edhe më
3 përpara, i nderuar Gjykatës, unë kam si synim që të them se ku
4 ka qenë klienti im gjatë gjithë kohës operative që mbulohet
5 nga aktakuza në fjalë.

6 Gjithë kjo varet nga nxjerrjet e materialeve që do t'i
7 marrim, jam i sigurt, në momentin e fundit. Kemi 98 dëshmitarë
8 konfidencialë, nga të cilët 68 do të na bëhen me dije 30 ditë
9 para gjykimit. Dhe pastaj 23 të tjerë, 30 ditë përpara
10 dëshmisë së tyre. Si dhe 46.000 faqe informacioni. E gjithë
11 kjo duhet të bëhet përpara procesit gjyqësor.

12 Kur e ngremë këtë çështje, i nderuar Gjykatës, ka pasur
13 çështje të shumta, ka qenë e vështirë për neve për të
14 diskutuar me dëshmitarë të ndryshëm.

15 Dhe besoj që e keni parë edhe në parashtrimin që kemi
16 bërë që ne kemi kërkuar që të heqim protokollin për një prej
17 dëshmitarëve që është në listën e ZPS-së, i cili dëshiron që
18 të jetë pjesë e listës sonë. Mund t'ju jap numrin për
19 procesverbal, por megjithatë e kemi dhënë këtë numër edhe në
20 parashtrimin e protokolluar tonin. Do të kërkojmë që ky
21 dëshmitar të kalojë në listat tona. Është një zotëri në një
22 moshë të thyer që ka qenë pjesë e deponimit që iu është
23 dorëzuar juve, i nderuar Gjykatës.

24 Sa i takon pikave faktike dhe juridike. Ne kemi 18 fakte
25 për të cilët kemi rënë dakord me ZPS-në. I kemi dhënë 135

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 59

1 fakte ZPS-së. Kam përshtypjen që është dërguar ky material të
2 hënën nga ekipi jonë sa i takon krimeve nga serbët në vitin
3 1998 dhe 1999.

4 Lidhur me dorëzimin e njoftimeve që kanë të bëjnë me
5 kundërshtimet, ne do të dorëzojmë kundërshtimet, por ato janë
6 të përgjithshme në natyrë pa u futur në gjëra konkrete. Pse?
7 Për shkak të dëshmitarëve që janë përfshirë dhe për shkak të
8 informacionit që marrim, që mund të vijë nga ZPS-ja ose nga
9 organet shtetërore serbe. Sigurisht, në këtë kuadër ne nuk
10 është se do të prezumojmë ndonjë gjë. Por, gjithsesi janë
11 çështje të cilat na vënë përpara disa vështirësi. Ne do të
12 dorëzojmë parashtrimet tona më datën 8, siç është kërkuar prej
13 jush i nderuar Gjykatës.

14 Dhe kam përshtypjen që kam përfshirë çdo gjë në atë çfarë
15 na është kërkuar që të raportojmë. Në qoftë se kam lënë ndonjë
16 gjë pa thënë, ju lutem na thoni.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

18 Z. Emmerson?

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi asgjë tjetër për të
20 shtuar përveç asaj çka kemi parashtruar me shkrim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young?

22 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Znj. Alagendra?

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar,

1 i nderuar Gjykatës.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

3 Alagenda.

4 Z. Prokuror, dëshironi që t'i përgjigjeni parashtimeve
5 të Mbrojtjeve ose atyre me shkrim, ose parashtimeve që bëri
6 z. Kehoe në sallën e gjyqit?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Do të flas shkurt.

8 Sa i takon fakteve për të cilat palët bien dakord, siç u
9 tha dhe siç u vlerësua, ne do të respektojmë afatin kohor më
10 datë 18 nëntor.

11 Megjithatë, këto nxjerrje nuk të çojnë në përshpejtimin e
12 procesit. Asnjë fakt i propozuar nuk lidhet me krimet e
13 pretenduara të kryera nga forcat serbe.

14 Sa i takon redaktimeve në aktakuzë, janë shpjeguar. Ka
15 një afat që duhet të respektohet për heqjen e redaktimeve, kjo
16 është pjesë e parashtimit 1064, shtojca 2. Këto janë
17 redaktime që janë objekt i masave mbrojtëse.

18 Ekipet e Mbrojtjes më thonë që kjo është e vështirë për
19 ata, por gjithsesi kjo është diçka që duhet të bëhet sepse
20 këto paragrafë janë objekt i masave mbrojtëse. Dhe ka mënyra
21 të tjera që Mbrojtjet mund të informohen për t'u përgatitur
22 për procesin gjyqësor. Afatet janë të qarta dhe pasojat të
23 cilat janë detyruese për palët pas zbulimit të redaktimeve, po
24 aq janë të qarta.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Kehoe?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Jemi shumë të vetëdijsëm për
3 detyrimet tona. I kemi respektuar të gjitha urdhrat që keni
4 dhënë. Nuk është se kemi asnjë lloj udhëzimi, asnjë tregues
5 për frikësim të dëshmitarëve. Ne i kuptojmë plotësisht
6 rregullat dhe urdhrat e dhëna në këtë gjykatë dhe i kemi
7 respektuar ato plotësisht.

8 Pavarësisht kësaj, dhe thënë kjo veçmas mënjanë, ky është
9 një proces që duhet të ndodhë ku palët të jenë në gjendje të
10 barabartë, pra të kenë rregulla loje të njëjta. Sepse
11 Prokuroria vazhdon që ta bëjë përgun e vet më të lartë sa i
12 takon mosnxjerrjes së materialeve redaktive të tjerë, e tjerë
13 dhe nuk kemi të bëjmë më me një lojë me rregulla të njëjta.
14 Duhet ta njohim këtë gjë.

15 Ne do të vazhdojmë t'i respektojmë vendimet e Gjykatës
16 siç kemi bërë deri tani. Por, me informacionin që nuk na është
17 zbuluar nuk na është dhënë deri tani, nuk është vetëm e
18 vështirë por thuajse e pamundur për ne për të vijuar më tej.

19 Kemi 46.000 faqe informacion, siç tha kolegu jonë, që
20 është informacion shumë i rëndësishëm dhe që nxirret vetëm 30
21 ditë përpara gjykimit. Duhet që ta marrim këtë informacion në
22 një farë mënyre, por të thuash që ky nuk është një propozim i
23 vështirë për ne apo një nxjerrje e tillë e materialeve, nuk e
24 dimë nëse një gjë e tillë ka ndodhur në gjykata të tjera, siç
25 pretendohet nga Prokuroria, por fakti është një gjë e tillë

1 nuk ka ndodhur.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Halling, shkurt ju lutem.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ka një element që nuk e ceka. Kjo
5 ka të bëjë me protokollin e kontaktit të dëshmitarit që u
6 përmend nga Mbrojtja.

7 Mbrojtja e Thaçit, dhe në fakt asnjë nga ekipet e tjera
8 të Mbrojtjes, nuk ka kontaktuar dëshmitarët në përputhje me
9 protokollin në këtë rast. Dhe Mbrojtja e Thaçit nuk ka ndjekur
10 asnjëherë asnjë lloj procedure që ka të bëjë me kontaktimin e
11 dëshmitarëve.

12 Kjo është një tjetër përpjekje për të respektuar -- një
13 tjetër përpjekje e jona për të nxjerrë në pah nevojën për të
14 respektuar protokollin për dëshmitarët.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Protokolli na kërkon që të kemi
16 intervista me praninë e ZPS-së. Asnjëherë në historikun e
17 çështjeve që kam qenë i përfshirë unë në të shkuarën, në asnjë
18 hetim që kam kryer, nuk e kam marrë palën tjetër të jetë e
19 pranishme aty për të bërë pyetje. Të gjitha këto çështje i
20 kemi zbërthyer, i kemi nxjerrë më përpara. I kemi thënë
21 shqetësimet tona lidhur me protokollin. I nderuar Gjykatës, ju
22 i dini këto shqetësime tona.

23 Këto janë çështje të cilat janë domethënëse, të cilat
24 kanë ndikim mbi privilegjin ndërmjet klientëve dhe Mbrojtjes
25 në mënyrën se si do t'i realizojmë ne këto hetime.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 63

1 Sa i takon të folurit me dëshmitarët. Me atë protokoll që
2 ekziston, ne pengohemi që të kryejmë hetimet tona në ato
3 rrethana. Në qoftë se ZPS-ja mendon që kjo duhet të jetë
4 mënyra si duhet të vijohet më tej ose në qoftë se ne nuk do të
5 veprojmë ndryshe, mendoj se e kanë keq në qoftë se mendojnë
6 kështu. Mendoj që për të treguar besim të mirë, ata duhet të
7 largohen nga protokollin.

8 Unë po ju them që ky dëshiron jetë një dëshmitar i
9 Mbrojtjes. Kështu që, si pasojë ZPS-ja nuk mund ta kontaktojë
10 atë. Nuk lejohet që ZPS-ja ta kontaktojë këtë person fare,
11 sepse ne po e informojmë atë që bëhet fjalë që ky person është
12 dëshmitari jonë, dëshmitar i Mbrojtjes.

13 Ne mund t'i anashkalojmë të gjitha këto çështje, të heqim
14 protokollin sa i takon këtij dëshmitari ndërkombëtar
15 profesionist dhe të vazhdojmë të ecim përpara në këtë çështje.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kjo do të vendoset me
17 vendim me shkrim.

18 Nuk shikoj se ndonjë tjetër dëshiron të marrë fjalën,
19 kështu që kalojmë tek pika tjetër në rendin e ditës, lista e
20 dëshmitarëve të ZPS-së.

21 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja thotë se synon të japë
22 një listë provizore të 40 dëshmitarëve të vet fillestarë më
23 datë 18 nëntor 2022, siç është urdhëruar në Konferencën e
24 fundit për Ecurinë e Çështjes.

25 Lidhur me rregullin 153, 154, 155, pra deklaratat që janë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 64

1 bërë sipas këtij rregulli, ZPS-ja thotë që synon që të
2 dorëzojë mocionet e para që kërkojnë pranimin në prova të
3 këtyre dokumenteve sipas rregullores, përpara fillimit të
4 gjykimit.

5 Ftoj ZPS-në që të bëjë komente të tjera shtesë lidhur me
6 këtë element.

7 Z. Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Parashtrimet me shkrim i cekën të
9 gjitha shqetësimet tona. Kështu që në qoftë se nuk keni ndonjë
10 pyetje tjetër, mjaftohemi me këto.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Kehoe.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon këtyre dëshmitarëve, dhe
14 e kam fjalën këtu veçanërisht për informacionin që ka të bëjë
15 me dëshmitarët 153, 154, 155, informacioni është voluminoz.
16 Për shembull, në rastin e 155-ës [sipas përkthimit], bëhet
17 fjalë për 12 dosje informacion. Kështu që ajo çfarë na duhet
18 të dimë ne është që, cilët janë ato dokumente në atë deklaratë
19 të dëshmitarëve sipas Rregullës 154 ku do ta mbështesin atë.

20 Nuk mjafton të vihet para gjykatës dhe të thuhet që, këto
21 janë 12 dosjet dhe gjejeni dokumentin.

22 Kështu që, i nderuar Gjykatës, neve kërkojmë ca kufizime.
23 Kërkojmë që Prokuroria të na thotë se çfarë informacioni do të
24 përdoret dhe të mos ta lërë këtë në prag të fillimit të
25 procesit gjyqësor.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 65

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson, dëshironi ta
2 merrni fjalën për këtë pikë?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

5 Z. YOUNG: [Përkthim] Thjesht dua ta theksoj edhe një herë
6 atë çfarë u vu në pah nga z. Kehoe.

7 Mbase nuk e mbani mend, por në seancën për ecurinë e
8 çështjes në korrik, në parashtrimet tona me shkrim ne e bëmë
9 absolutisht të qartë që Prokuroria duhet të jetë në gjendje që
10 të identifikojë dhe të nxjerrë informacionet ku do të
11 mbështetet në procesin gjyqësor, sepse kjo do të na kursente
12 goxha kohë. Kjo është një procedurë e cila ka të bëjë me
13 administrimin e duhur të çështjes. Kështu që ata duhet të
14 thonë se ku mbështeten, cilët janë dokumentet që duan të
15 mbështeten për çështjen e tyre, duke qenë se bëhet fjalë për
16 mijëra e mijëra dokumente.

17 Edhe sot e kësaj dite ne nuk është se kemi marrë një
18 përgjigje për këtë kërkesë, që mendoj se është një kërkesë e
19 rëndësishme për ne.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. Alagendra ose kolegu tjetër.

22 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kam shumë për të shtuar.

23 Thjesht mbështes kërkesën që u bë nga Mbrojtja e z. Thaçi dhe
24 kolegëve të tjerë.

25 Thjesht dua që të kuptojmë fushën e veprimit dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 66

1 madhësinë e mocionit dhe dokumenteve që duhet të na nxirren.
2 Kështu që mendojmë që kjo është një praktikë e mirë për
3 administrimin e çështjes dhe si rezultat do të duhet të na
4 jepet më shumë informacion nga Prokuroria.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për vonesën.

7 Në parashtrimet tona në kuadrin e ditës së sotme nën
8 çështje të tjera, ne kemi ngritur në 4(b) çështjen e
9 deklaratave të dëshmitarëve 153, 154, 155 në lidhje me
10 dëshmitarët të cilët kanë burime të shumta të provave.

11 Dhe me siguri ka dëshmitarë për të cilët ka 6 ose 7
12 dokumente të ndryshme konfliktuale, të cilët në qoftë se do të
13 dorëzohen si dokumente përpara gjykatës, duhet të jenë
14 koherente. Sepse në të kundërtën Mbrojtja, Trupi i Gjykimit
15 dhe Prokuroria në fund do të duhet të vendosin në një fazë më
16 të vonshme se cilin version të ngjarjeve do të përdorin si
17 bazë të tyre. Kjo nuk mund t'i shërbejë interesit të
18 drejtësisë.

19 Kështu që, i nderuar z. Gjykatës, do ju kërkonim që për
20 çdo dëshmitar që do të pranohet mbështetur në rregullin 153,
21 154, 155, Prokuroria të mund të përgatisë një deklaratë
22 përmbledhëse të provave që synojnë që të nxjerrin nga këta
23 dëshmitarë. Dhe të gjithë dokumentin t'ia vënë në dispozicion
24 Trupit Gjykues, në mënyrë të tillë që të ketë mundësi Trupi
25 Gjykues edhe Mbrojtja që të bëjnë pyetje për besueshmërinë e

1 dëshmitarëve.

2 Trupi Gjykses duhet të dijë se çfarë saktësisht nga ky
3 dëshmitar X, për shembull, është me rëndësi ose ku mbështetet
4 Prokuroria. Është shumë e vështirë për neve që të dimë në
5 qoftë se dëshmitarët të cilët kanë dhënë më shumë se sa një
6 version, në qoftë se versionet kanë qenë konsistente kanë qenë
7 në një linjë me njëra-tjetrën apo jo. Nuk e dimë, për
8 shembull, në qoftë se dëshmitarët kanë dhënë dëshmi në çështje
9 të tjera. Nuk e dimë se çfarë informacionesh janë kërkuar që
10 të pranohen dhe nuk e dimë se çfarë niveli kontradiktor ose
11 mospërputhje ka në dokumentet e tjera. Kështu që për këtë
12 arsye është e rëndësishme për Prokurorinë që të identifikojnë
13 se ku mbështetet.

14 Përveçse të thonë se cilat janë këto materiale ku po
15 mbështetemi, është e rëndësishme që të jepen edhe hollësi të
16 tjera. Duhet që secila prej këtyre dëshmime të kristalizohet
17 në një përmbledhje të saktë lidhur me atë çfarë ka thënë
18 dëshmitari dhe që propozon Prokuroria që të pranojë në prova.

19 Në fund të ditës, këto janë vështirësi që duhet t'i
20 kalojë vetë Prokuroria. Dhe në qoftë se Prokuroria nuk i
21 kapërcen dot këto vështirësi, atëherë i takon që provat ose
22 dëshmitë nuk duhet të jenë të pranueshme.

23 Ky është një parim i zakonit, pavarësisht nëse procesi
24 gjyqësor zhvillohet në gjykatat kombëtare ose në gjykatat
25 ndërkombëtare. Dhe çdo gjë që ka të bëjë me besueshmërinë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 68

1 dëshmitarit duhet që të përcaktohet nga Trupi Gjykses, si në
2 momentin kur e pranon provën, por edhe në momentin kur vendos
3 rëndësinë që i bashkëlidhet provës në fjalë.

4 Prokuroria nuk është asgjëkund gati për të qenë në
5 gjendje që të japë informacion mbështetur në këto dispozita në
6 qoftë se nuk jep dëshmi të cilat janë koherente, janë të
7 linjësuara nga dëshmitarët, në qoftë se synon që të mbështetet
8 në dëshmitë e tyre. Kështu që do t'ju kërkonim, i nderuar z.
9 Gjykatës, që t'i kërkonim Prokurorisë edhe të identifikohen
10 mungesat e konsistencës nga dokumentet të cilat do të
11 parashtrohen nga Prokuroria, por këtë do t'ia kërkojmë Trupit
12 Gjykses. Por, mënyra se si e kuptojmë ne pozicionin e
13 Prokurorisë për momentin, është që Prokuroria dëshiron që
14 thjesht të na hedhë një tufë materialesh dhe të na thotë që,
15 ja ku i keni materialet. Por nuk është kjo mënyra sesi
16 trajtohet një çështje. Duhet që materiali të jetë koherent dhe
17 të jetë i administrueshëm nga Trupi Gjykses.

18 Ne jemi në pozitë për t'i bërë këto kërkesa -- nuk e mbaj
19 mend se kur thamë që do bëheshin. Por, përpara fillimit të
20 gjykimit, kjo ishte pak a shumë afati. Dhe ato duhet të bëhen
21 me prova për të justifikuar pranueshmërinë dhe të mos thuhet
22 vetëm thjesht pohohet që kjo do të bëhet, por duhet që ajo
23 çfarë thuhet të mbështetet me prova. Dhe kjo në vetvete do të
24 duhet të testohet siç duhet. Për secilin prej këtyre
25 dëshmitarëve do të ketë sfida të shumta.

1 Siç e keni parë edhe nga dosja paragjyqësore e jona, ka
2 dëshmitarë tek të cilët mbështetet Prokuroria që kanë të bëjnë
3 me të vetmet raste në dosje ku thuhet që Z. Veseli, për
4 shembull, ka qenë i pranishëm në disa -- dhe të cilat ne i
5 kemi shpjeguar në dosjen tonë, pa dhënë shpjegime më tej
6 Prokuroria. Megjithatë, ajo çfarë është e rëndësishme është që
7 pse duhet t'i pranojë Trupi Gjykses këto dëshmitarë mbështetur
8 në dëshmitë e tjera që ata kanë dhënë në çështje të tjera ose
9 në elementë ose aspekteve të tjera, të cilat janë të
10 rëndësishme për besueshmërinë e tyre.

11 Të gjitha këto janë elementë që duhet t'i shqyrtojë Trupi
12 Gjykses përpara se të merret vendimi për t'i pranuar në prova
13 këto dëshmi apo jo. Nuk mjafton që Prokuroria thjesht t'i japë
14 një tufë të madhe informacioni Trupit Gjykses, siç sugjerohet
15 aktualisht, sepse kjo nuk është në përputhje me rregulloren.
16 Përmbushja ose plotësimi i rregullës është që të jepet një
17 shpjegim i provave dhe pjesëve të dëshmisë në të cilat
18 mbështetet Prokuroria, shoqëruar edhe me nxjerrjen për Trupin
19 Gjykses dhe gjithashtu edhe për Mbrojtjen, çdo gjë që mund të
20 shkojë në kundërshtim të kredibilitetit të besueshmërisë së
21 dëshmitarëve.

22 Jam i lumtur që kjo do të bëhet përpara gjykimit, por nga
23 ana tjetër pa diskutim që kjo kërkon që ju të përcaktoni një
24 afat kohor. Për shembull, në fund të janarit në qoftë se
25 mendohet se do të fillojë çështja në vitin që vjen.

1 Nuk është një pikë e parëndësishme. Përkundrazi, siç mund
2 ta mbani mend, kemi pasur diskutime të shumta sa i takon
3 harmonizimit të çështjes së Prokurorisë edhe Prokuroria ka
4 refuzuar për të zvogëluar fushën e veprimit të aktakuzës. Por
5 në vend të kësaj kanë insistuar në mënyrë të vazhdueshme që të
6 marrin prova për çdo akuzë të mundshme në aktakuzë,
7 pavarësisht faktit që akuza të caktuara nuk kanë të bëjnë fare
8 me të akuzuarin. Për të shkurtuar afatin kohor, ata e kanë
9 sugjeruar parashtrimin e provave me shkrim.

10 Mirë, nuk kemi ndonjë problem për këtë, por nga ana
11 tjetër do të duhet që këtë ta bëjnë siç duhet dhe në afatet e
12 parashikuara. Ne kemi dëshmitarë në periudhën paragjyqimit dhe
13 jam i sigurt që Trupi Gjyqës do të presë që Prokuroria të
14 bëjë punën e vet.

15 Dhe për shembull, në qoftë se do të marrim tregimin që
16 juve keni kërkuar një urdhër për Mbrojtjen për të identifikuar
17 kundërshtimet për sa i takon pranimit të provave, dhe mendoj
18 se flas në emër të kolegëve të mi këtu, që ne mund ta bëjmë
19 këtë gjë duke bërë referimet në kategoritë, por jo duke bërë
20 referimet në dëshmitarët duke pasur parasysh afatin në
21 dispozicion. Sepse ne nuk e kemi këtë material, nuk kemi asgjë
22 me të cilën mund të luftojmë për momentin, sepse Prokuroria
23 vetëm thjesht përmend numra, thotë 154, 155. Por neve na
24 nevojitet material i qenësishëm, i prekshëm dhe na duhen afate
25 kohore, për shembull, 31 dhjetor.

1 Dhe në qoftë se, për shembull, Prokuroria thotë që do të
2 duhet të punojë gjatë pushimeve, kjo është puna e tyre nuk
3 është puna e jonë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Halling, në lidhje me
5 parashtimet dhe me propozimin për caktimin e një afati nga
6 fundi i këtij viti për këto materiale.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

8 Preferencat e z. Emerson nuk janë një zëvendësim për
9 Rregulloren e Procedurave dhe të Provave. Nuk ka asnjë kriter
10 në këtë Rregullore që kërkon hartimin e ndonjë përmbledhjeje
11 gjithëpërfshirëse të një dëshmie të dëshmitarëve.

12 Mendimet mund të jenë të ndryshme dhe këtu përfshihet
13 edhe çështja e afateve se kur do të bëhen këto kërkesa. Ne
14 thamë që do t'i bëjmë kërkesat e para sipas këtyre rregullave
15 përpara fillimit të gjykimit. Për të qenë plotësisht të qartë,
16 këto kërkesa do të përmbajnë informacion specifik në lidhje me
17 provat përkatëse për çdo dëshmitar dhe të gjitha materialet
18 mbështetëse të nevojshme për plotësimin e kushteve
19 procedurale.

20 Nuk ka një kriter që kërkon që këto kërkesa të
21 parashtrohen përpara fillimit të gjykimit. Ne duam thjesht që
22 këto t'i dorëzojmë dhe do të jetë çështje për të cilën duhet
23 të merret vendim nga Trupi Gjykses.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

25 Z. Emerson.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Rregullorja që përmend z.
2 Halling, rregullat përkatëse fillojnë me formulimin ku thuhet:
3 "Paneli mund të pranojë dëshminë me shkrim të një
4 dëshmitari, apo transkriptin e dëshmisë së një dëshmitari".

5 Ngjashmërisht thuhet në rregullin 155:

6 "Dëshmi në formë të deklaratës me shkrim apo çfarëdo
7 deklaratë tjetër të regjistruar të asaj që ka thënë një
8 person".

9 Të gjitha këto janë referenca ndaj diçkaje që Prokuroria
10 e identifikon si pjesë e akuzave dhe provave që duhet të
11 paraqitet para Trupit Gjykses. Atë që tha edhe z. Kehoe, bëhet
12 fjalë për 12 dosje materiale.

13 Prokuroria duhet të bëjë punën e vet dhe kjo do të thotë
14 që Trupi Gjykses duhet të ketë përpara një deklaratë të qartë.

15 Pse ata nuk mund ta bëjnë punën si duhet? Ata po bëjnë
16 pengesa gjatë gjithë procedurës, po i shkelin afatet, po
17 vonohen me dhënien e materialeve dhe në disa raste, siç pamë
18 edhe sot, në mënyrë të qëllimshme nuk i paraqesin provat.

19 Dhe duhet që këtë aspekt ta zgjidhin, sepse në qoftë se
20 vazhdojmë sikurse po vepron Prokuroria, të akuzuarit do të
21 mbeten të paktën edhe 3 vjet në paraburgim përpara se të
22 fillojë një gjykim i mirëfilltë.

23 Prokuroria qartë nuk i ka plotësuar detyrimet e tyre,
24 detyrime që ka një Prokuror profesional. Prokuroria duhet të
25 identifikojë qartë se mbi cilat pjesë të deklaratës së një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 73

1 dëshmitari mbështeten dhe të gjitha këto pjesë më të
2 rëndësishme t'i nxjerrë në një dokument të vetëm. Për sa i
3 përket materialeve të tjera mbështetëse, në rregull. Mirëpo,
4 si mundet ne t'i përgjigjemi një kërkesë sipas rregullës 155,
5 kur për shembull, ato dokumente përmenden kolektivisht me një
6 numër ERN. Mendoj që duhet t'i japim fund kësaj çmendurie.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
8 Nuk shoh dikë tjetër që dëshiron të marrë fjalën.

9 Përpara se të kalojmë tek pika në lidhje me kalimin e
10 çështjes Trupit Gjykues, palët kanë bërë disa parashtime.

11 Në parashtimin me shkrim Mbrojta e z. Thaçi ka kërkuar
12 shfuqizimin e vendimit kornizë për trajtimin e informacionit
13 konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktin midis palëve apo
14 pjesëmarrësve me një dëshmitar të palës tjetër. Për një
15 dëshmitar specifik që ka të bëjë me kërkesën për mundësi
16 hetimore unike, informoj Mbrojtjen e z. Thaçi se unë do të
17 marr vendim në lidhje me këtë kërkesë në kontekstin e kërkesës
18 për masa hetimore unike.

19 Mbrojtja e Thaçit, në mbështetje të Mbrojtjes Veseli,
20 gjithashtu kërkon një urdhër ku ZPS-ja të urdhërohet që në
21 mënyrë sistematike të identifikojë pjesët me më pak të
22 redaktuar të dokumenteve të cilave iu janë hequr redaktimet.
23 Prokuroria ka bërë të ditur se nuk është e gatshme ta bëjë
24 këtë.

25 Ftoj përfaqësuesit e Prokurorisë që të paraqesin

1 parashtrimet e tyre në lidhje me këtë pikë.

2 Urdhëroni z. Prokuror.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Në lidhje me këtë pikën e fundit.

4 Kjo nuk është e realizueshme sepse kjo kërkon shumë punë.

5 Duhet që të identifikohet çdo redaktim apo version i

6 redaktuar. Unë mendoj se kjo nuk është e domosdoshme dhe e

7 nevojshme.

8 Kodet, të ashtuquajtura e-code, të redaktimeve jo

9 standarde e bëjnë të qartë se cilat pjesë apo përmbajtje të

10 një versioni të redaktuar, për cilat pjesë bëhet fjalë dhe

11 cilat do të hiqen.

12 Modalitetet teknike të këtij aspekti janë të qarta për

13 Mbrojtjen. Dhe ata mbajnë përgjegjësinë për të kuptuar

14 përmbajtjen e materialeve që i nxirret. Kjo nuk është detyrë e

15 ZPS-së.

16 Në qoftë se nuk keni diçka tjetër në lidhje me këtë,

17 atëherë ne si Prokurori nuk kemi më parashtrime në lidhje me

18 këtë pikë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se të vazhdojmë, të

20 pyesim përfaqësuesin e Zyrës Administrative nëse Zyra

21 Administrative mund të na ndihmojë me këtë, meqë bëhet fjalë

22 për një aspekt teknik. Atëherë ndoshta ekziston ndonjë program

23 që mund të na mundësojë krahasimin e 2 versioneve të

24 dokumenteve që janë të redaktuara dhe prej të cilave janë

25 hequr redaktimet për të identifikuar pjesët prej të cilave

1 janë hequr redaktimet.

2 Z. Nilsson, a mendoni se këtë çështje mund ta diskutoni
3 në zyrën tuaj për të na ndihmuar ta zgjidhim këtë aspekt
4 teknik?

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Keni të drejtë, nuk mund t'ju
6 përgjigjem menjëherë. Por do ta shqyrtojmë këtë mundësi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.
8 Urdhëroni, z. Kehoe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne në bisedimet *inter partes* jemi
10 përpjekur që të gjejmë një mënyrë të arsyeshme se si t'i
11 qasemi këtij problemi.

12 Pika e parë që duhet të trajtojmë është se shpesh ndodh
13 që marrim nga ZPS-ja dokument dhe na thuhet që ky është
14 dokument i paredaktuar, por nuk na thuhet se cili redaktim
15 është hequr. Dhe thjesht ne po marrim informacionin copë-copë.

16 Jemi mësuar tashmë që t'i kalojmë dokumentet prej
17 fillimit deri në fund në bazë të informacionit që na është
18 dhënë prej Prokurorisë për heqjen e redaktimeve. Mbas një
19 deklarate të Prokurorisë, për shembull, se ky është tani
20 version i paredaktuar i një dokumenti paraprakisht të
21 redaktuar, ne fillojmë punën e kontrollojmë dokumentin dhe e
22 shikojmë që dokumenti në fakt nuk është i redaktuar.

23 Prandaj në atë pjesën që është e redaktuar ne mendojmë se
24 ata shkruajnë diçka si një farë kodi ku thotë që ka qenë më
25 parë i redaktuar. Nuk e shoh se çfarë problemi ka që këto

1 pjesë të shënohen me ndonjë ngjyrë të verdhe apo me ngjyrë
2 tjetër, apo në ndonjë mënyrë tjetër që të zgjedhë vetë
3 Prokuroria. Nuk është kjo shumë punë shtesë për Prokurorinë.

4 Në qoftë se z. Nilsson ka një zgjidhje për këtë, dhe ai
5 zakonisht gjen zgjidhje, kjo do të ishte e shkëlqyer. Dhe do
6 të na e lehtësonte punën dhe do të na bënte të kuptonim se
7 çfarë është ndryshuar.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

9 Urdhëroni z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të theksoj, në qoftë se më
11 lejoni, një fjali prej asaj që tha z. Halling. Ai tha:

12 "Mbrojtja është përgjegjëse për ta kuptuar përmbajtjen e
13 materialeve që i nxirren. Nuk i takon ZPS-së që të bëjë punën
14 e Mbrojtjes".

15 Ky është pikërisht i njëjti qëndrim që merr ZPS-ja edhe
16 në lidhje me materialet e rregullës 155 dhe 156. Është një
17 qëndrim që e dëgjojmë vazhdimisht. Sipas Prokurorisë, nuk
18 është kjo një çështje që do t'i shërbente interesave të
19 drejtësisë, e interesit të përgatitjes së çështjes për gjykim.
20 Ajo që ka rendësi për Prokurorinë është vetëm në qoftë se në
21 rregull shprehimisht thuhet se ky është detyrim i Prokurorisë
22 dhe duhet të bëhet.

23 Në çdo juridiksion kombëtar apo të vendeve, detyra e
24 Prokurorisë është që t'i shërbejë gjykatës dhe të hetojë dhe
25 të paraqesë përpara një Trupi Gjykues provat mbi të cilat ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 77

1 vendosur të mbështetet. Roli i prokurorit në secilën shoqëri
2 të civilizuar është që t'i shërbejë interesit të drejtësisë
3 dhe jo interesit partizan të sigurimit të një vendimi fajësie.

4 Kështu përgjigjet z. Halling në lidhje me të gjitha
5 kundërshtimet që ne i parashtrojmë si Mbrojtje: "Ne nuk duam
6 ta bëjmë këtë. Kjo i takon Mbrojtjes, ata duhet ta bëjnë punën
7 e vet". Dhe nuk merren parasysh pengesat me të cilat
8 ballafaqohet Mbrojtja. Çdo herë që ngrihet në këmbë z.
9 Halling, këtë qëndrim mban. Dhe këtë qëndrim e ka shfaqur në
10 çdo seancë që kemi pasur deri tani. Është, si ta quash, një
11 lajtmotiv i z. Halling që e kemi parë vazhdimisht.

12 Ky ekip i Prokurorisë ka dështuar në kryerjen e detyrave
13 të veta. Duhet t'i vihet fundi, duhet të disiplinohet në
14 mënyrë që të kryejë punën e vet në mënyrë të drejtë dhe të
15 përshtatshme. Është edhe në interes të Mbrojtjes si për
16 shembull z. Smith, sepse më kërkohet për shembull të kalohet
17 në seancë private vetëm që të mos përmendim në seancë publike
18 emrin e z. Smith.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

20 A keni diçka për të shtuar z. Halling?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Jo nuk kam.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

23 Atëherë do të kaloj tek kërkesa e Mbrojtjes së z. Thaçi,
24 e mbështetur edhe nga Mbrojtja e z. Veseli.

25 Në parashtrimet e tyre me shkrim z. Thaçi bën të ditur se

1 ZPS-ja ka miratuar një farë praktike të njoftimit të njerëzve
2 që i interviston se janë të pranishëm në intervistë në
3 cilësinë e tyre si të dyshuar, sepse ka arsye për të besuar se
4 kanë kryer apo janë përfshirë në kryerjen e ndonjë krimi që
5 është nën juridiksionit të DhSK-së.

6 Sipas Mbrojtjes, këta persona duhet të njoftohen nga ZPS-
7 ja se nuk kanë më statusin e personit të dyshuar, në mënyrë që
8 Mbrojtja të mund t'i kontaktojë më lehtësisht.

9 Urdhëroni z. Kehoe në qoftë se keni ndonjë parashtrim me
10 gojë në lidhje me këtë.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

12 Një numër i madh personash ish-anëtarë të UÇK-së të
13 cilëve iu është thënë se janë të dyshuar nga ZPS-ja gjatë
14 intervistave, asnjëherë nuk janë kontaktuar për t'ju thënë se
15 ky status i tyre nuk është më në fuqi. Për t'iu thënë se ata
16 më nuk janë të dyshuar.

17 E kemi paragrafin 35 ku ZPS-ja përfshin çdokënd që ka
18 qenë në UÇK në këtë ndërmarrje kriminale të përbashkët. Dhe
19 siç thashë, ka shumë persona të tillë në Kosovë dhe ish-
20 anëtarë të UÇK-së të cilëve iu është thënë se janë të dyshuar.

21 Krahas kësaj që e thashë për paragrafin 35, ka edhe disa
22 individë të tjerë të cilëve iu është thënë se UÇK-ja është një
23 aktor jo-shtetëror sekret mbas një fytyre publike.

24 Në një deklaratë të ZPS-së të dhënë para disa muajsh ku
25 UÇK-ja quhet një aktor jo-shtetëror sekret që vepron mbrapa

1 një kodi apo një farë heshtjeje. Një mendim i tillë mbizotëron
2 për vite me radhë.

3 Shikoni disa individë. Ata kanë pasur statusin e personit
4 të dyshuar para tre vitesh, katër vitesh dhe e kanë të njëjtin
5 status edhe sot e kësaj dite. Atyre nuk iu është thënë, nuk
6 janë kontaktuar që të informohen që tashmë nuk e kanë më atë
7 status.

8 Unë e kam parasysh rregullin 47 apo individët që kërkojnë
9 nga Gjykata t'iu përfundohet hetimi. Gjithsesi, është një
10 element i drejtësisë që në këtë pikë, në këtë fazë, njerëzit
11 të njoftohen se nuk trajtohen më si të dyshuar, në mënyrë që
12 ata të mund të dëshmojnë dhe të flasin lirshëm për atë që kanë
13 bërë.

14 Por, ta mbash këtë re të errët mbi këta dëshmitarë me
15 vite me radhë, vështirëson çdo përpjekje për të biseduar me
16 këta njerëz. Sepse ata kanë frikë se çfarë mund të jenë
17 pasojat për ta dhe kjo është rezultat i sjelljes së ZPS-së
18 ndaj tyre.

19 Prandaj ne kërkojmë që ZPS-ja t'ju drejtohet, qoftë edhe
20 në seancë *ex parte* dhe t'ju thotë këta persona ne nuk i
21 konsiderojmë të dyshimtë dhe mund t'i informojmë se nuk e kanë
22 më atë status.

23 Kjo është vetëm një çështje e ndershmerisë dhe drejtësisë
24 së procesit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

1 Z. Emmerson.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë do ta parashtroj këtë aspekt
3 nga një këndvështrim tjetër.

4 Është padyshim relevante kur një dëshmitar vjen për të
5 dhënë dëshmi në këto procedura, në qoftë se ai dëshmitar jep
6 dëshmi nën kërcënimin e ndjekjes penale. Me një rrezik të
7 tillë vjen edhe rreziku i pengesave të asaj se çfarë duhet të
8 nxirret, se çfarë duhet të hetohet dhe kështu me radhë nga
9 Trupi Gjykues.

10 Çdo dëshmitar, dhe ka një numër të konsiderueshëm të tyre
11 të cilët Prokuroria planifikon t'i thërrasë, kanë qenë të
12 dyshuar për kryerjen e ndonjë krimi dhe ne duam ta dimë se mbi
13 çfarë baze janë konsideruar të tillë.

14 Kështu që unë do të kërkoj për një urdhër sipas të cilit
15 çdo dëshmitar që ata propozojnë ta thërrasin dhe të cilët janë
16 paralajmëruar në fillim të intervistës se kanë statusin e
17 personit të dyshuar dhe të cilët do t'i kontaktojë Mbrojtja.

18 E dyta, në qoftë se Prokuroria ende e ka atë mendim për
19 ta dhe në qoftë se do t'i thërrasë për të dhënë dëshmi në atë
20 cilësi. Në qoftë se dikush është i dyshuar dhe bashkëpunon me
21 Prokurorinë, kjo është absolutisht e sigurt se informacioni do
22 të nxirret. Në qoftë se dyshimi mbetet, ne parashtrojmë se
23 ekziston rreziku që ai dyshim do të kërcënojë edhe dëshminë e
24 dëshmitarëve. Dhe kjo sidomos vlen për dëshmitarët që do të
25 thërriten për të dhënë dëshmi dhe dëshmitarët dëshmitë e të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 81

1 cilëve do të parashtrohen sipas rregullës 155 dhe rregullave
2 të tjera. Sepse Trupi Gjykses duhet të jetë i informuar se mbi
3 çfarë bazash Prokuroria i ka konsideruar ata të dyshuar në
4 fillim të intervistës dhe në qoftë se e ka po të njëjtin
5 pozicion edhe gjatë gjykimit dhe në qoftë se ka pasur ndonjë
6 ndryshim midis këtyre dy pikave kohore.

7 Do të thosha gjithashtu se nëse një dëshmitar aktualisht
8 është person i dyshuar dhe nëse nuk ka ndryshim të rrethanave
9 që do ta kishin ndryshuar qëndrimin e Prokurorisë, atëherë
10 dëshmitari ndodhet në rrezik të procedimit penal. Dhe kjo
11 është tejet e rëndësishme sepse në këtë rast kanë nevojë të
12 dinë dy gjëra. Së pari duhet që të paralajmërohen që në fillim
13 të dëshmisë që jo me doemos duhet t'ju përgjigjen të gjitha
14 pyetjeve, sepse për ndryshe mund të vetë fajësohen. Dhe se
15 kanë të drejtën për t'u përfaqësuar nga një avokat.

16 Ky është formimi minimal, besoj se Prokuroria e ka
17 menduar këtë, por dua përgjigjen e tyre.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Ndonjë prej ekipeve të tjera të Mbrojtjes dëshiron të
20 shtojë diçka?

21 Z. Young.

22 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit.

23 Me respektin më të madh për parashtrimet e bëra, ne i
24 mbështesim. Z. Kehoe dhe z. Emmerson kanë ngritur shqetësime
25 legjitime të cilat mund të ndikojnë shumë jetën e individëve

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 82

1 të cilët nuk e dinë nëse janë apo jo persona të dyshuar. Janë
2 apo jo dëshmitarë. Është diçka që e kemi ngritur edhe në
3 konferencat e mëparshme. Por, t'i lësh personat kështu t'i
4 mbash pezull kur ata nuk janë ende të dyshuar, por me mendjen
5 e tyre ata të vazhdojnë të kujtojnë sikur janë të dyshuar, kjo
6 cenon Mbrojtjen, sepse ndikon edhe tek mënyra se si këta
7 individë mund të diskutojnë me ekipet e Mbrojtjes, nëse janë
8 në kontakt me këto ekipe të Mbrojtjes. Pra, mund të ketë
9 pasoja cënuese për ne si Mbrojtje.

10 Z. Halling, lidhur me një çështje të mëparshme po
11 shpjegonte sesi gjërat janë të realizueshme, s'ka detyrim
12 Prokuroria për të përmbushur dhe shpjegoi gjithashtu edhe se
13 rruga që ne u kërkojmë atyre të ndjekim nuk është e nevojshme.
14 Z. Kehoe tha që rregulla mund të mos ketë, por ka njëfarë
15 ndershmërie që duhet ndjekur, njëfarë rruge të drejtë e cila
16 duhet ndjekur.

17 Por, ka dhe referenca. Është kodi i sjelljes dhe e kam
18 fjalën për kodin e sjelljes për Prokurorët dhe Mbrojtësit.
19 Sipas versionit që unë kam, në nenin 6(1):

20 "Mbrojtësit" që përfshin edhe Prokuroret, "në rolin dhe
21 proceduarat e tyre mes të tjerash duhet që të veprojnë në një
22 mënyrë që të jetë në përputhje me parimet e gjykimit të drejtë
23 dhe të drejtat e njeriut".

24 Dhe në shkronjën (g) të nenit 6(1):

25 "...duhet të mbajnë një standard të lartë të sjelljes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 83

1 profesionale në paraqitjen e provave, të bëjnë të gjitha hapat
2 e duhura për përmbushjen e detyrimeve me njohuri dhe aftësi
3 profesionale duke respektuar procedurën”.

4 Kjo është e drejtpërdrejtë e lidhur me atë për të cilën
5 ne po flasim. Po flasim për sjelljen nga ana e Prokurorisë e
6 cila nuk e përmbush këtë prag të drejtësisë, të ndershmërisë.
7 Dhe ka pasoja të drejtpërdrejta sidomos tek ne sepse nxit
8 kulturën e frikës, të padijes dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë
9 tek ne. Nuk janë këto çështje teorike, që ngremë ne, janë
10 probleme reale.

11 Ato që thanë z. Kehoe dhe z. Emmerson janë shqetësime
12 legjitime të cilat i nderuari Gjykatës duhet t'i mbajë
13 parasysh dhe t'i shqyrtojë.

14 Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Znj. Alagendra.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne mbështesim parashtrimet që
18 kanë bërë kolegët e nderuar. Nuk dua të përsëris ato që u
19 thanë, përpos që edhe ne e bëjmë kërkesën të cilën e përmendi
20 z. Emmerson.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shumë shkurt, sigurisht. Përpara
24 se të përgjigjet Prokuroria, nuk dua të ketë ndonjë keqkuptim
25 kur të përgjigjet z. Halling. Se nuk është detyrim i Mbrojtjes

1 që të përfaqësojë dhe të mbrojë dëshmitarët. Jo, nuk pa flasim
2 për këtë. Nuk po përfaqësojmë të drejtat e dëshmitarëve këtu.

3 Është çështje e gjykimit të drejtë pa një nxjerrje sipas
4 rregullës 103. Materialet që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me
5 besueshmërinë e dëshmitarëve, ka të bëjë me gjykimin e drejtë.
6 Dhe ajo që ka rëndësi të madhe krahas kësaj, nuk është thjesht
7 se përfaqësojmë interesat e të akuzuarve, por është në interes
8 të gjykatës që të caktojë, të emërojë përfaqësues juridik për
9 ata persona për të cilët Prokuroria nuk e ka ndërruar mendjen.

10 Sepse do të vinë dëshmitarë këtu të japin dëshmi pa e
11 ditur nëse mbase edhe mund të përdoren kundër tyre në proceset
12 e ardhshme. Z. Krasniqi dhe z. Selimi kanë qenë dëshmitarë të
13 Prokurorisë në procedurat e mëparshme në TPNJ dhe tani ndodhen
14 këtu në bankën e të akuzuarve. Kështu që mund të ndodhë e
15 njëjta gjë me dëshmitarë të Prokurorisë për shkak të natyrës
16 dhe dëshmisë që ata do të japin këtu. Unë nuk po kundërshtoj
17 ndonjë nga këto.

18 Por, puna është që duhet të paralajmërohen se nuk janë të
19 detyruar që të dëshmojnë dhe se mund të marrin avokat,
20 përveçse kur Prokuroria e ndërron mendjen që të anulojë faktin
21 që ata janë të dyshuar dhe të jenë thjesht dëshmitarë të
22 thjeshtë.

23 Këto janë standardet minimale të nxjerrjes dhe detyrime
24 që i përkasin edhe Gjykatës përpara se të thirret një
25 dëshmitar. I respektoj parashtrimet e z. Kehoe dhe

1 parashtrimet e mëparshme për dhembshurinë për interesat e
2 individëve. Por nuk është kjo detyra jonë. Detyra jonë është
3 që të kujdesemi për drejtësinë e procedurës për hir të
4 klientëve tanë. Problemi që këta mund të kenë është se nuk e
5 kanë trajtuar këtë çështje.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

7 Tani e ka rendin ZPS-ja që të përgjigjet. Z, Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Unë do të përpiqem ta mbaj të
9 ndrydhur instinktin që të kundërshtoj të debatoj për ato që ka
10 thënë Mbrojtja e z. Veseli për sa i takon ndershmërisë dhe
11 drejtësisë.

12 Por, të fokusohemi tek ajo për të cilën po flasim. Shumë
13 prej parashtrimeve të Mbrojtjes kanë rrjedhur nga një
14 keqkuptim sikur ne po bëjmë ndonjë vlerësim subjektiv kur
15 vendosim nëse një person është apo jo i dyshuar. Neni 38(3) i
16 Ligjit na detyron që të informojmë këdo në intervistë se ka
17 baza për të besuar se kanë kryer krime në juridiksion të DhSK.
18 Nëse është përmbushur kjo, atëherë duhet ta informojmë
19 personin. Është një standard objektiv. Është një detyrim që
20 rrjedh nga ligji. Nuk është diçka subjektive.

21 Për të thënë të vërtetën lidhur me atë që ka thënë edhe
22 z. Kehoe, jo të gjithë personat që kanë qenë anëtarë të UÇK-së
23 e kanë përmbushur këtë gjë, janë vlerësuar si të dyshuar. Por,
24 nëse duam të themi të vërtetën është që të dyshuarit e kanë
25 detyrim që të kontaktojnë ZPS-në nëse dëshirojnë. Por është

1 një e drejtë e personit që të kenë dhe avokat kur kanë
2 kontakte me ZPS-në. Por këtë e vendosin ata.

3 Për sa i takon një parashtrimi tjetër, kjo është një
4 kërkesë e pabazuar, na është bërë pa njoftim dhe ne duam që të
5 dimë se çfarë baze jurisprudence. Unë nuk e kam dëgjuar
6 ndonjëherë nga një institucion tjetër përpara. Kur ta marrim
7 këtë bazë do të përgjigjemi siç duhet ndaj kësaj kërkesë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Kehoe.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Këta persona janë informuar para
11 disa vitesh se janë persona të dyshuar. Dhe unë nuk po
12 kundërshtoj që duhet informuar personi. Mbase e kanë informuar
13 personin.

14 Por kanë kaluar vite pas këtij informimi që u është dhënë
15 këtyre personave. Dhe këta persona ende ndodhen nën kërcënimin
16 mendor se janë persona të dyshuar. Ndërkohë që ZPS-ja nuk u
17 thotë që, nuk janë më persona të dyshuar. Është një situatë
18 interesante kjo ku ZPS-ja në bazë të sjelljes së tyre, në
19 shumë raste para shumë vitesh, i frikëson psikologjikisht
20 shumë prej këtyre.

21 Janë shumë e shumë dëshmitarë të cilëve ZPS-ja u ka thënë
22 që janë persona të dyshuar duke i frikësuar në mënyrë që ata
23 të mos thonë atë që dinë. Sepse kanë frikë se mos ZPS-ja u
24 kthehet pastaj dhe i akuzon nëse thonë ndonjë gjë që nuk i
25 pëlqen asaj.

1 Shumë, shumë prej këtyre ish-anëtarëve të UÇK-së
2 luftëtarëve të cilëve iu është bërë klasifikimi si persona të
3 dyshuar. Mos është e tepruar t'iu themi apo të detyrojmë ZPS-
4 në t'ju thotë që, nuk janë më të dyshuar? T'i çlirojmë nga kjo
5 frikë, nga kjo fantazmë?

6 Ta lemë mënjanë materialin 103. Thjesht nga që i volit
7 ZPS-së që këto persona të rrojnë nën frikën e procedimit, ato
8 të mos u tregojnë atyre që ata nuk janë persona të dyshuar?

9 Unë ju kërkoj që nëse nuk janë më persona të dyshuar, me
10 mirëbesim t'ju thuhet që është kështu.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë nuk dua që të vendoset lidhja
14 midis meje dhe interesave të dëshmitarëve.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Këtë e kuptuam.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt përgjigja ime për z.
17 Halling është kjo, përgjigja e tij është vërtetë, na tregon
18 shumë. Disa prej tyre janë intervistuar si të dyshuar, disa
19 jo. Dhe ata që janë intervistuar kështu, siç e tha z. Halling,
20 duheshin informuar për këtë gjë sepse kishin kaluar standardin
21 objektiv, e theksoj fjalën objektiv, të vendosur nga
22 Prokuroria që, nëse në bazë të një vlerësimi kishte baza për
23 të dyshuar se kishin kryer një krim brenda juridiksionit të
24 gjykatës, atëherë duheshin informuar paralajmëruar për këtë.

25 Nuk është ndonjë masë subjektive mbrojtëse që ka bërë

1 Prokuroria. Por, nëse është informuar kështu, atëherë duhet
2 informuar edhe cilat janë bazat. Për të ndarë shapin nga
3 sheqeri, duhet që të ketë kritere duhet informuar për këto
4 kritere që janë përdorur kur personi është apo jo i dyshuar.
5 Pra, ai është nga ana e të dyshuarve dhe jo nga ana tjetër.

6 Ndërkohë që z. Halling thotë që s'ka dëgjuar në asnjë
7 procedurë tjetër detyrimin që t'i tregohen Mbrojtjes provat
8 përkatëse të cilat mund të jenë edhe shfajësuese se dyshohet
9 që personi ka kryer një krim. Kam frikë se kjo tregon një
10 mungesë relative përvoje nga ana e tij, sepse ky është një
11 element universal që e gjen në çdo sistem drejtësie në mbarë
12 botën, sepse besueshmëria e një individi i nxirret i tregohet
13 nga ana e prokurorisë, mbrojtjes. Dhe neve këtë procedurë e
14 kemi në rregullin 103, e cila është e detyrueshme për
15 Prokurorinë.

16 Nuk e di se çfarë ka ndodhur, por nëse Prokuroria nuk e
17 kupton që kanë detyrim që të nxjerrin edhe bazat për
18 Mbrojtjen, atëherë kam frikë se ata nuk kanë ekspertizën
19 legale për të punuar në Prokurori.

20 Nëse ka ndryshuar kjo gjë, ne sigurisht kemi të drejtë të
21 dimë se çfarë ishte baza dhe pse ka ndryshuar, sepse kjo ka
22 lidhje të drejtpërdrejtë me akuzat e ngritura në aktakuzë ndaj
23 të akuzuarve.

24 Ka dëshmitarë kyç të cilët i japin dëshmi Prokurorisë,
25 për shembull fjala vjen, për organizimin e Shtabit të

1 Përgjithshëm të UÇK-së. Në fillim të intervistës janë
2 informuar paralajmëruar që janë të dyshuar, por duket se nuk
3 janë më persona të dyshuar për Prokurorinë. Ata nuk e
4 përmbushin më standardin objektiv për të qenë i dyshuar se ke
5 kryer një krim në juridiksion të Gjykatës, sepse po të ishte
6 kështu do të ishte në bankën e te akuzuarve, jo në bankën e
7 dëshmitarëve. Ose nëse është përndryshe, gjithsesi duhet që të
8 nxirret.

9 Nuk e di se ç'po ndodh në atë anën tjetër të sallës, por
10 ky material duhet të nxirret patjetër. Dhe duhet të nxirret
11 tani, përpara se të fillojë procesi gjyqësor sepse ka lloj-
12 lloj pasojash dhe rrjedhojash për avokatët që duhet t'i
13 përfaqësojnë këta individë, për të drejtën e tyre për të mos
14 dëshmuar. Dhe ka mundësinë për ta nxjerr nga shinat të gjithën
15 procedurën.

16 Përtej faktit që është e vetëdukshme, megjithëse duhet që
17 t'ia lexojmë z. Halling, ky material është i vetëdukshëm që
18 duhet nxjerrë dhe në mënyrë të ligjshme e kërkon edhe
19 Rregullorja që të nxirret. Unë nuk e kuptoj sesi dikush që
20 flet në emër të Prokurorisë të thotë që, "jo nuk ka rregull
21 për këtë". Sigurisht që ka, por edhe këtu z. Halling i bën
22 bisht detyrimit. Nuk e mendon fare nëse ka apo jo detyrim. Ai
23 thotë, "jo s'ka fare detyrim, s'ka detyrim në Rregullore për
24 ne kështu që Prokuroria s'ka nevojë të bëj asgjë, mjafton që i
25 kemi këto proceduara dhe janë të drejta".

1 Shpresoj që z. Halling të ketë pasur mundësinë që ta
2 rishikojë qasjen e tij.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Halling.

5 Z. Kehoe, keni folur dy herë.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Parashtrimi ynë ka të bëjë me
7 dëshmitarët e UÇK-së që janë jo vetëm në listën e
8 dëshmitarëve, por edhe për ata dëshmitarë që nuk janë në
9 listën e dëshmitarëve të cilëve iu është bërë paralajmërimi si
10 persona të dyshuar. Dhe janë shumë të tillë. Pra, jo vetëm
11 dëshmitarët që Prokuroria synon t'i thërrasë këtu, por edhe të
12 gjithë ata të tjerët me të cilët kemi të bëjmë.

13 Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

15 Z. Halling

16 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Gjykatës.

17 Siç e tha z. Emmerson me ndershmëri për mua.

18 Çështja këtu nuk është nëse një person nxirret apo jo.
19 Sepse kjo është premisa, sepse këtë ia kemi komunikuar
20 Mbrojtjes. Nuk flitet as me arritjen e ujdive, që është tjetër
21 gjë. Ajo që po shikojmë tani është që ZPS-ja duhet që të
22 krijojë material për të shpjeguar pse një person ishte i
23 dyshuar dhe nëse vazhdon ta mendojë apo jo nëse ky person
24 është i dyshuar, thjesht për hir të nxjerrjes tek Mbrojtja.
25 Këtë duhet që t'ia parashtrojmë Gjykatësit me shkrim dhe do ta

1 përfshijmë në parashtrimin tonë të protokolluar me shkrim.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

3 Nuk shoh ndonjë kërkesë tjetër për të marrë fjalën.

4 Do të kalojmë tani tek shqetësimi nga Mbrojtja e Veselit
5 sa i takon riklasifikimit të materialit provues.

6 Mbrojtja e Veselit kërkon që ZPS-ja të japë shpjegime të
7 individualizuara për dokumentet që kërkon të klasifikojë si
8 konfidenciale.

9 Për këtë çështje vë re se ZPS-ja ka dorëzuar dje
10 parashtrim të protokolluar për një gjë që ka lidhje me
11 gushtin, pas një kërkesë nga Mbrojtja e Veselit. Dhe në
12 parashtrimet e ZPS-së ka një listë dokumentesh të cilat mund
13 të riklasifikohen si publike.

14 Në fillim do t'ia jap fjalën Mbrojtjes nëse dëshiron që
15 të plotësojë parashtrimet që ka bërë me shkrim. Dhe pastaj do
16 t'ia jap fjalën ZPS-së.

17 Znj. O'Reilly.

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Shumë shkurt. Kjo sigurisht
19 është dorëzuar përpara se ta kishim këtë listë të dokumenteve
20 që mund të klasifikoheshin si publike.

21 Ka disa paketa të cilat kanë lidhje me dy dëshmitarë,
22 prandaj dhe është e mundshme që të jepet një përshkrim i
23 përgjithshëm që ka lidhje me këtë vendim apo të tjera. Por ka
24 dhe qindra dokumente ku thuhet se janë klasifikuar si
25 konfidenciale për shkak të kontekstit në të cilën është marrë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 92

1 informacioni, natyra e dhënësit të informacionit dhe sa i
2 takon identifikimit të dëshmitarëve të ZPS-së apo të
3 viktimave, por kjo nuk mjafton. Kjo do të thoshte çdo gjë sa i
4 takon këtyre dokumenteve të cilat mbahen konfidenciale. Sepse
5 mjafton përdorimi i fjalës "dhe/ose" ky justifikim mund edhe
6 të mos zbatohet për dokumentet e asaj pakete.

7 Dhe në bazë të kësaj ne kërkojmë një shpjegim specifik
8 zë-për-zë, dokument-për-dokument. Nëse nuk bëhet dot dokument-
9 për-dokument, të paktën të bëhet për grupe dokumentesh pa këtë
10 formulimin me frazën "dhe/ose".

11 Faleminderit shumë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. O'Reilly.

13 Z. Prokuror keni fjalën.

14 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, besoj se i
15 kemi trajtuar shumë prej këtyre çështjeve në parashtrimin tonë
16 me shkrim që e dorëzuar dje. Ajo që mund të themi është se
17 paketat e nxjerrjes janë kategoria e dokumenteve për të cilat
18 ne zbatojmë klasifikimin dhe nëse klasifikimi nuk është i
19 mjaftueshëm apo nëse justifikohet ri-klasifikim, këtë e vendos
20 Trupi Gjykses.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

22 Nuk shoh ndonjë kërkesë tjetër për të marrë fjalën për
23 këtë çështje.

24 Kalojmë tani tek pikëpamjet e palëve sa i takon kalimit
25 të çështjes Trupit Gjykses dhe domosdoshmërisë apo jo për të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 93

1 zhvilluar një konference për ecurinë e çështjes, përpara
2 kalimit të çështjes.

3 Vërej se palët nuk parashikojnë ndonjë vështirësi sa i
4 takon kalimit të çështjes Trupit Gjykues përpara fundit të
5 vitit. Por, Mbrojtja vëren se përpara kalimit të çështjes,
6 ZPS-ja duhet që të këtë përfunduar të gjitha detyrimet e veta
7 të papërfunduara për nxjerrjen dhe vendimet mbi masat
8 mbrojtëse apo kundërshtimet të materialitetit të dokumenteve
9 që janë dorëzuar.

10 Vërej në këtë fazë se palët nuk parashikojnë nevojën për
11 një konferencë tjetër për ecurinë e çështjes përpara kalimit
12 të çështjes Trupit Gjykues. U kërkoj palëve që të japin
13 mendimet e tyre lidhur me këtë çështje, duke filluar nga
14 Prokuroria.

15 Z. Halling, keni fjalën.

16 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës.

17 Bëtë një përmbledhje shumë të saktë të gjithë atyre
18 pikave. E vetmja gjë që dua të them është që disa prej ekipeve
19 flasin për përfundimin e detyrimeve të ZPS-së përpara se sa
20 t'i transferohet çështja Trupit Gjykues.

21 Megjithatë, megjithëse nuk nevojitet të thuhet, më lejoni
22 të them që ka disa kërkesa të cilat nuk i përmbushim dot, si
23 për shembull mosnxjerrjen e materialeve të caktuara 30 ditë
24 përpara fillimit të Trupit Gjykues ose detyrimet për nxjerrjen
25 e informacionit sipas rregullës 103.

1 Por, pyetja që shtrohet besoj është në qoftë se
2 Prokuroria mund të plotësojë të gjitha detyrimet e saj përpara
3 se sa t'i transferohet çështja Trupit Gjykues, sesi pas asaj
4 çfarë lejohet sipas kuadrit ligjor.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne nuk parashikojmë ndonjë arsye pse
7 nuk mund të transferohet çështja deri në fund të vitit. Edhe
8 një herë, e dimë që do të ketë nxjerrje në vazhdimësi.
9 Megjithatë, lidhur me atë çfarë kemi diskutuar sot ose
10 Konferencës së fundit për Ecurinë e Çështjes, është e
11 rëndësishme që të kemi sa më shumë informacion që të jetë e
12 mundur nga Prokuroria përpara se sa t'i transferohet çështja
13 Trupit Gjykues. Këtë ju kërkojmë, i nderuar Trupi Gjykues.
14 Megjithatë, nuk kemi kundërshtim që t'ia transferoni çështjen
15 Trupit Gjykues deri në fund të vitit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka një gjë që duhet të trajtohet
18 dhe ky është ndërveprimi ndërmjet çështjes që ne diskutuam në
19 seancë të mbyllur, kërkesës që është pezull dhe duhet të
20 shqyrtohet në varësi të dokumentacionit që ka të bëjë me
21 manipulimet e mundshme të shërbimit inteligjent serb që është
22 pjesë e dokumenteve që duhet nxjerrë sipas rregullës 103. Dhe
23 do të duhet që të shikohen të gjithë këto elementë, sepse
24 është shumë e rëndësishme që këto të merren parasysh përpara
25 se sa t'i transferohet çështja Trupit Gjykues.

1 Kemi dy vjet që presim dhe në qoftë se ne e fitojmë
2 kërkesën tonë, në qoftë se kërkesa merr një përgjigje
3 pozitive, atëherë i takon që Prokuroria do të duhej të shikojë
4 të gjithë nxjerrjet e informacioneve që ata kanë dhënë deri
5 tani. Dhe në qoftë se rezulton që kjo do të jetë qasje e
6 gabuar, atëherë gjyqtarët do të duhet që ta bëjnë absolutisht
7 të qartë këtë gjë.

8 Mendoj që ky është një element i cili do të ketë një
9 element shumë i rëndësishëm mbi nxjerrjen e informacionit. E
10 kam fjalën për materialet të cilat janë përdorur nga shërbimet
11 sekrete jugosllave. Por, përgjigja që dha z. Halling për çdo
12 gjë, sepse ata e dinë që nuk i përmbushin dot detyrimet që
13 kanë në kuadrin kohor legjitim, kështu që përgjigja e tij
14 interpretohet sikur ata po mundohen që gjërat duhen të
15 dorëzohen dhe vonesa e tyre për nxjerrjen e informacionit do
16 të vazhdojë.

17 Megjithatë, do të doja t'ju sugjeroja që të parashikoni
18 një afat kohor për shkëmbimin e arsytetimeve ligjore dhe
19 shpjegimet që duhet t'i japë z. Tieger apo ndokush tjetër
20 lidhur me çfarë nuk ka funksionuar dhe të merrni një vendim
21 ju, i nderuar Gjykatës, për materialin sipas rregullës 103,
22 përpara se sa t'i transferohet çështja Trupi Gjykses. Kjo
23 sepse duhet që përpara se çështja t'i dërgohet Trupit Gjykses,
24 ata të dinë se çfarë ka thënë Prokuroria dhe Prokuroria do të
25 duhet që të justifikojë qëndrimin e vet përpara Trupit Gjykses.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 96

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Besoj se e imagjinoni se
2 çfarë pyetje do të bëj tani?

3 Z. EMERSON: [Përkthim] Po, e imagjinoj.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sa kohë?

5 Z. EMERSON: [Përkthim] Shtatë ditë.

6 A mund t'ju kërkoj, i nderuar Gjykatës, që t'i kërkon
7 Prokurorisë që të përgjigjet për 7 ditë?

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, në rregull.

9 Z. Young?

10 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kemi gjë për të shtuar.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra?

12 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk shikoj ndonjë vështirësi për
13 transferimin e çështjes Trupit Gjykses përpara fundit të
14 vitit. Dhe nuk shikojmë ndonjë domosdoshmëri për ndonjë tjetër
15 seancë.

16 Nuk mendojmë që është e nevojshme që të bëjmë një seancë
17 tjetër për ecurinë e çështjes përpara transferimit të çështjes
18 Trupit Gjykses. Në përjashtim të rasteve kur mbase mund të
19 ketë çështje themelore që kërkojnë një seancë me gojë. Mendoj
20 që njoftimet ose përditësimet mund të dërgohen para Gjykatës
21 me shkrim.

22 Gjëja e fundit është që e mbështesim kërkesën që u bë nga
23 z. Emerson sa i takon materialit sipas rregullës 103.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Përpara se t'ia jap fjalën Mbrojtjes së Viktimave, z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 97

1 Halling, ju lutem a mund t'i përgjigjeni parashtrimeve të z.
2 Emmerson sa i takon planit për informimin që ka të bëjë me
3 kërkesën për materialin sipas rregullës 103.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, sigurisht që
5 nuk kemi kundërshtim për vendimin që mund të merrni ju për sa
6 i takon përgjigjes së kësaj kërkesë. E vlerësojmë dhe e lemë
7 në duart tuaja sa i takon afatit kohor.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
10 flas.

11 Duhet që të jepet përgjigje nga Prokuroria përpara se
12 çështja t'i dërgohet Trupi Gjykues, sepse pastaj do të duhet
13 që të shikojmë implikimet për nxjerrjen e informacionit.

14 Kështu që, unë personalisht sugjeroj që deri sa të keni
15 vendosur ju për këtë çështje, i nderuar Gjykatës, ne nuk
16 vendosim dot nëse na nevojitet një tjetër konferencë për
17 ecurinë e çështjes apo jo.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

19 Z. Laws, fjala për ju.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Nga këndvështrimi ynë nuk ka ndonjë
21 vështirësi për transferimin e çështjes Trupit Gjykues deri në
22 fund të vitit. Sërish, nga këndvështrimi ynë nuk është e
23 nevojshme që të kemi një tjetër konferencë për ecurinë e
24 çështjes.

25 Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 98

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

2 Z. Nilsson, ndonjë gjë nga ana e Zyrës Administrative?

3 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, s'kemi asgjë nga ana e Zyrës
4 Administrative.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

6 Tani duhet t'i kërkoj palëve pjesëmarrësve në qoftë se
7 kanë ndonjë çështje tjetër që dëshirojnë të ngrenë.

8 Z. Prokuror?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Asgjë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Asgjë, i nderuar Gjykatës.

12 Besoj se e keni vënë re që dosja paragjyqësore është
13 dorëzuar në kohën e duhur. Dhe keni parë gjithashtu edhe
14 numrat ERN të dokumentit që kemi marrë nga burimet e hapura po
15 nga ZPS-ja. Kështu që, duke pasur parasysh këto rrethana dhe
16 mungesën e informacionit, ne nuk do të dorëzojmë një tabelë
17 sipas 109(c) tani. Besoj se deri të hënën nuk do të kemi
18 mundësi që të dorëzojmë një tabelë sipas asaj që kërkohet në
19 Rregullin 109(c).

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Emerson.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Asgjë për të thënë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kemi asgjë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi asgjë

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të bëjmë një pushim për
5 rreth 25 minuta dhe pastaj do të mblidhemi sërish për disa
6 vendime me gojë përpara se sa ta mbyllim këtë konferencë të
7 ditës së sotme.

8 --- Pauza fillon në orën 16.37

9 --- Seanca rifillon në orën 17.03

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se të përfundojmë
11 seancën e sotme do ta nxjerr urdhrin e parë në lidhje me
12 materialet e 102(3), në lidhje me materialet që ka kërkuar
13 Mbrojtja pas 20 majit 2022.

14 Urdhëroj ZPS-në të përfundojë me përpunimin e këtyre
15 kërkesave, përkatësisht të kërkojë masa mbrojtëse ose të
16 paraqesë kundërshtime në lidhje me rëndësinë materiale ose të
17 nxjerrë të gjitha materialet që nuk janë objekt i kërkesave
18 për masa mbrojtëse ose i kundërshtimeve mbi rëndësinë
19 materiale deri me 18 nëntor 2022.

20 Këtu përfundon urdhri im i parë gojor.

21 Tani do të lëshoj urdhrin e dytë gojor në lidhje me
22 materialet e rregullës 102(3) nga njoftimi plotësues i
23 materialeve sipas kësaj rregulle.

24 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, urdhëroj ZPS-
25 në të përfundojë me përpunimin e këtyre kërkesave,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 100

1 përkatësisht të kërkojë masa mbrojtëse, të paraqesë
2 kundërshtime në lidhje me rëndësinë materiale ose të nxjerrë
3 të gjitha materialet që nuk kanë objekt i kërkesave për masa
4 mbrojtëse ose i kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale deri më
5 13 janar 2023.

6 Këtu përfundon urdhri im i dytë gojor.

7 Tani do të nxjerr urdhrin e tretë gojor në lidhje me
8 nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 103.

9 Urdhëroj ZPS-në që ta bëjë rivlerësimin e njoftimit
10 plotësuar sipas rregullës 102(3) në lidhje me materialet
11 shfajësuese dhe ta nxjerrë këtë material sipas urdhrit, sipas
12 rregullit 103 apo të kërkojë masa mbrojtëse në lidhje me atë
13 material deri me 16 dhjetor 2022.

14 Këtu përfundon urdhri im i tretë gojor.

15 Tani do të lëshoj urdhrin e katërt gojor lidhur me
16 riklasifikimin e provave.

17 Me kërkesë të Mbrojtjes së Veselit, dhe kjo është
18 parashtrimi numër F00766, urdhërova ZPS-në të bënte
19 rivlerësimin e materialit provues që nuk ishte konfidencial
20 dhe të bënte të ditur ndër të tjera se cili materialet mund të
21 riklasifiohet si publik në këtë fazë. Ky është parashtrimi
22 F00934.

23 ZPS-ja parashtroi se 8076 materiale të nxjerrja që nuk
24 janë konfidenciale mund të riklasifikohen si publike dhe se
25 pjesa e mbetur e provave duhej të mbeten me klasifikimin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 101

1 "konfidenciale" për të mbrojtur kufizimet në lidhje me
2 materialet e brendshme të punës dhe dhënësit të informacionit
3 për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët, për të parandaluar
4 çdo cenim të mundshëm të hetimeve aktuale apo të mundshme dhe
5 për të ruajtur interesin publik të palëve të treta.

6 Pasi kam rishikuar shtojcën F01079 paraqitur nga
7 Prokuroria jam bindur se materialet mund të riklasifikohen si
8 publike.

9 Në përputhje me këtë urdhëroj që materialet provuese të
10 renditura në parashtrimin F01079-A01 të riklasifikohen si
11 publike dhe urdhëroj ZPS-në që këtë ndryshim të statusit ta
12 reflektojnë në sistemin *Legal Workflow*. Zyra Administrative
13 udhëzohet që sipas nevojës ta ndihmojë ZPS-në në këtë drejtim.

14 Po kështu, në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores
15 urdhëroj Zyra Administrative të bëjë riklasifikimin si
16 "publike" të parashtrimit F01079-A01 dhe çdo përkthimi
17 përkatës të tij.

18 Këtu përfundon urdhri gojor i katërt i imi.

19 Tani do të lëshoj urdhrin e pestë gojor në lidhje me
20 parashtrimin plotësues F00877-COR.

21 Urdhëroj Mbrojtjen që të dorëzojë parashtrimet e veta
22 plotësuese deri të hënën, 14 nëntor 2022; ZPS-në të përgjigjet
23 deri të enjten, 24 nëntor 2022; dhe Mbrojtjen të
24 kundërpërgjigjet nëse dëshiron deri me 29 nëntor 2022.

25 Këtu përfundoj urdhrin im i pestë gojor.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë për Ecurinë e Çështjes (Seancë e hapur)

Faqe 102

1 Dhe në fund tani do të lëshoj urdhrin e gjashtë gojor.

2 Urdhëroj ZPS-në që kur të bëjë parashtrimin e listës së
3 40 dëshmitarëve të parë që do t'i thërrasë për të dhënë dëshmi
4 të bëjë të ditur se cilët pjesë të dëshmive të tyre përkatëse
5 do të kërkojë t'i paraqesë si prova, të pranohen si prova,
6 sipas rregullës 154.

7 Këtu përfundon urdhri i gjashtë gojor.

8 Këtu përfundon seanca e sotme. Mendoj që është edhe e
9 fundit përpara kalimit të çështjes Trupit Gjykues.

10 Falënderoj si zakonisht të gjithë pjesëmarrësit,
11 përkthyesit, personelin audiovizuel, stenografin dhe të
12 sigurisë.

13 Këtu përfundon seanca.

14 --- Konferenca e për Ecurinë e Çështjes mbyllet
15 në orën 17.09

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25